



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 195/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Nenad Lazić dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lart ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), paraqitur kundër Koalicionit PDK-AAK-NISMA për shkak të vendosjes së panove-banerit brenda hapsirave të shkollës në komunën e Mitrovicës, në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 12.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa Anr 195/2017 e datës 11.06.2017 parashtruar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI).

A r s y e t i m

Me datën 11.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) në të cilën thekson se në afërsi të shkollës Migjeni në qendrën e votimit 1102B në Mitrovicë monitoruesit e tyre kanë hasur në një pano reklamuese të kandidatit për deputet nga koalicioni PDK-AAK-NISMA të ngjitur në hapësirë publike dhe në afërsi të shkollës më pak se 100 metra nga qendra e votimit. Parashtruesi i ankesës thekson se me këto veprime është shkelur neni 36 paragrafi 1 i LZP-së, dhe si dëshmi ka bashkangjitur foto.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar:

Parashtruesi i ankesës me ankesën e tij pretendon se në afërsi të shkollës Migjeni në qendrën e vendvotimit 1102B në Mitrovicë monitoruesit e tyre kanë hasur një pano reklamuese të kandidatit për deputet nga koalicioni PDK-AAK-NISMA të ngjitur në hapësirë publike dhe në afërsi të shkollës më pak se 100 metra nga qendra e votimit

Paneli, vlerëson se ankesa e parashtruar është e pa bazuar ngase nga fotoja e dorëzuar si dëshmi nuk mund të identifikohet se është shkolla fillore Migjeni apo Qendra e Votimit 1102B.


Prandaj, PZAP-i në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 195/2017 më datën 12.06.2017

Kryesuesi i Panelit

Adnan Konushevc



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.